SONY

4-418-233-**11**(1) (AL)

HOME AUDIO DOCKING SYSTEM

Udhëzimet e përdorimit

(1)

©2012 Sony Corporation

FST-GTK33iP/GTK11iP
RDH-GTK33iP/GTK11iP

AL

http://www.sony.net/

R·D·S

Made for iPod iPhone

PARALAJMËRIM

Për të reduktuar rrezikun e zjarrit, mos mbuloni hapësirën e ajrimit me gazeta, mbulesa tavoline, perde, etj. Mos vendosni mbi aparaturë burime me flakë të pambrojtur siç janë qirinjtë e ndezur.

Për të reduktuar rrezikun e zjarrit ose goditjeve elektrike, kjo aparaturë nuk duhet të ekspozohet ndaj pikimeve ose spërkatjeve me ujë dhe mbi aparaturë nuk duhen vendosur objekte të mbushura me lëng, siç janë vazot.

Mos e instaloni pajisjen në një hapësirë të kufizuar, si në një raft librash ose në një mobilie inkaso.

Duke qenë se spina kryesore përdoret për të shkëputur njësinë nga rrjeti elektrik, lidheni njësinë me një prizë lehtësisht të arritshme rryme të drejtpërdrejtë. Nëse vini re një anomali në njësi, shkëputni menjëherë prizën kryesore nga priza e rrymës së drejtpërdrejtë.

Mos ekspozoni bateritë ose aparaturën me bateri të instaluara ndaj nxehtësisë së tepruar siç janë drita e diellit, zjarri ose të ngjashme me to.

Njësia nuk shkëputet nga rrjeti elektrik për sa kohë që është e lidhur me prizën e rrymës së drejtpërdrejtë, edhe nëse njësia vetë është e fikur.

Njoftim për klientët: informacioni i mëposhtëm aplikohet vetëm për pajisjet e shitura në vendet ku aplikohen direktivat e BE-së.

Prodhuesi i këtij produkti është Sony Corporation, 1-7-1 Konan Minato-ku Tokyo, 108-0075 Japoni.
Përfaqësuesi i autorizuar për EMC dhe sigurinë e produktit është Sony Deutschland GmbH, Hedelfinger Strasse 61, 70327 Stuttgart, Germany. Për çdo çështje shërbimi ose garancie, ju lutemi referojuni adresave që jepen në dokumentet e veçanta të shërbimit ose garancisë.

Për klientët në Evropë dhe Australi:

Hedhja e pajisjeve të vjetra elektrike dhe elektronike (E aplikueshme në Bashkimin Evropian dhe vendet e tjera evropiane me sisteme grumbullimi të diferencuar)

Ky simbol mbi produkt ose mbi paketimin e tij tregon se ky produkt nuk duhet të trajtohet si mbeturinë shtëpiake. Përkundrazi, do të dorëzohet pranë pikës përkatëse të grumbullimit për riciklimin e pajisjeve elektrike dhe elektronike. Duke u siguruar që ky produkt të hidhet siç duhet, ju ndihmoni në parandalimin e pasojave të mundshme negative për mjedisin dhe shëndetin, që në rast të kundërt do të shkaktoheshin nga trajtimi i materialeve dhe i mbetjeve të këtij produkti. Riciklimi i materialeve do të ndihmojë në ruajtjen e burimeve natyrore. Për më shumë informacion të detajuar mbi riciklimin e këtij produkti, ju lutemi kontaktoni me bashkinë tuaj, shërbimin e grumbullimit të mbeturinave shtëpiake ose dyqanin ku keni blerë produktin.
Aksesorët e aplikueshëm: Telekomanda

(Modelet evropiane)

Hedhja e baterive të përdorura (e aplikueshme në Bashkimin Evropian dhe vendet e tjera evropiane me sistem grumbullimi të diferencuar)

Ky simbol mbi bateri ose mbi paketim tregon se bateria e dhënë me këtë produkt nuk duhet të trajtohet si mbeturinë shtëpiake.
Në disa bateri, ky simbol mund të përdoret i kombinuar me një simbol kimik. Simbolet kimike për zhivën (Hg) ose plumbin (Pb) shtohen nëse bateria përmban më shumë se 0,0005% zhivë ose 0,004% plumb.
Duke u siguruar që këto bateri të hidhen siç duhet, ju ndihmoni në parandalimin e pasojave të mundshme negative për mjedisin dhe shëndetin që në rast të kundërt do të shkaktoheshin nga trajtimi i papërshtatshëm i mbetjeve të kësaj baterie. Riciklimi i materialeve do të ndihmojë në ruajtjen e burimeve natyrore.
Në rast produktesh të cilat për arsye sigurie, rendimenti apo integriteti të dhënash kërkojnë lidhje të qëndrueshme me një bateri të inkorporuar, kjo bateri duhet të zëvendësohet vetëm nga personel i kualifikuar shërbimi. Për të siguruar trajtimin e duhur të baterisë, dorëzojeni produktin në fund të periudhës së funksionimit të tij pranë pikës përkatëse të grumbullimit për riciklimin e pajisjeve elektrike dhe elektronike.
Për të gjitha bateritë e tjera, ju lutemi shihni pjesën që flet mbi heqjen e sigurt të baterisë nga produkti. Dorëzojeni baterinë pranë pikës përkatëse të grumbullimit për riciklimin e baterive të përdorura.
Për më shumë informacion të detajuar mbi riciklimin e këtij produkti ose baterie, ju lutemi kontaktoni me bashkinë tuaj, shërbimin e grumbullimit të mbeturinave shtëpiake ose dyqanin ku keni blerë produktin.

Njoftim për licencat dhe markat tregtare

- iPhone, iPod, iPod classic, iPod nano, dhe iPod touch janë marka të Apple Inc., të regjistruara në Shtetet e Bashkuara dhe vende të tjera.
- Patentat dhe teknologjia koduese audio MPEG Layer-3 janë të licencuara nga Fraunhofer IIS dhe Thomson.
- Windows Media është markë tregtare ose markë tregtare e regjistruar e Microsoft Corporation në Shtetet e Bashkuara dhe/ose vende të tjera.
- Ky produkt përmban teknologji që janë subjekt i disa të drejtave të pronësisë intelektuale të Microsoft. Ndalohet përdorimi ose shpërndarja e kësaj teknologjie jashtë këtij produkti pa licencën/licencat përkatëse nga Microsoft.
- Të gjitha markat e tjera tregtare dhe markat e regjistruara janë marka të zotëruesve të tyre përkatës. Në këtë manual nuk specifikohen markat ™ dhe ®.

Vendndodhja e kontrolleve

Njësia (lart)



Njësia (përpara)



Shënim
Dalja e kufjes nuk është e disponueshme sepse ky sistem nuk ka fole për kufje.

Telekomanda



Ky manual shpjegon kryesisht përdorimin duke përdorur telekomandën, por të njëjtat operacione mund të kryhen edhe duke përdorur butonat në njësi që kanë emra të njëllë ose të ngjashëm.

Për të bllokuar butonat në njësi (funksioni i bllokimit për fëmijët)

Ju mund të bllokoni butonat përveç I/⏻ (ndezur/gatishmëri) 5 në njësi për të parandaluar që ato të përdoren gabimisht.
Mbani shtypur ■ 14 në njësi derisa "CHILD LOCK ON" ose "CHILD LOCK OFF" të shfaqet në ekran 8. Butonat përveç I/⏻ 5 në njësi do të bllokohen ose zhbllokohen.

Shënim
Bllokimi për fëmijët mund të anulohet kur shkëputni kordonin e energjisë.

Këshillë
Përdorimi i butonave të telekomandës është i mundur edhe kur aktivizohet funksioni i bllokimit për fëmijët.

Fillimi



A Energjia

Lidheni kordonin e rrymës me një prizë muri.
Demonstrimi shfaqet në ekran 8. Kur shtypni I/⏻ 5, sistemi ndizet dhe demonstrimi përfundon automatikisht.
Nëse adaptori i dhënë në prizë nuk përputhet me prizën tuaj të murit, shkëputeni nga priza (vetëm për modelet e pajisura me adaptor).

B Audio në L/R (foletë DVD/PC IN)

Lidhni një komponent opsional si luajtësit dixhitalë audio ose një pajisje me dalje audio analoge, duke përdorur një kabllo hyrëse audio RCA të disponueshme në shitje.

C Antenat

Kur futni konektorin e antenës përcjellëse FM/antenës me kornizë AM, sigurohuni që ta fusni në orientimin e duhur.
Gjeni një pikë dhe një orientim që ofron marrje të mirë sinjali kur vendosni antenat.
Mbajini antenat larg nga kordoni i rrymës për të shmangur marrjen e zhurmës.

Instalimi i sistemit

Sistemi mund të instalohet qoftë vertikalisht apo horizontalisht. Zgjidhni llojin e instalimit bazuar në preferencat tuaja (përveç përdoruesve të modelit iPod nano). Vini re se me këtë sistem, kërkohet instalimi horizontal kur përdorni modelet iPod nano.

Pozicioni horizontal



Pozicioni vertikal



Përdorimi i telekomandës

Futni dy bateri R6 (përmasa AA) (të dhëna), duke puthitur polaritetet e treguara më poshtë.



Shënime mbi përdorimin e telekomandës
- Me përdorimin normal, bateritë duhet të zgjasin për rreth 6 muaj.
- Mos përzieni një bateri të vjetër me një të re ose lloje të ndryshme baterish.
- Nëse nuk e përdorni telekomandën për një periudhë të gjatë kohe, hiqni bateritë për të shmangur dëmtimet nga rrjedhja dhe gërryerja e baterive.

Vendosja e orës

1 Shtypni I/⏻ 5 për të ndezur sistemin.
2 Shtypni TIMER MENU 16 për të zgjedhur modalitetin e vendosjes së orës.
Nëse pulson "PLAY SET", shtypni ↑/↓ 20 në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur "CLOCK", dhe më pas shtypni ⊕ (hyrje) 17.
3 Shtypni ↑/↓ 20 në mënyrë të përsëritur për të vendosur orën, më pas shtypni ⊕ 17.
4 Përdorni të njëjtën procedurë për të vendosur minutat.

Shënim
Cilësimet e orës rivendosen kur shkëputni kordonin e rrymës ose nëse ka shkëputje të përgjithshme të rrymës elektrike.

Për të shfaqur orën kur sistemi është i fikur

Shtypni DISPLAY 25. Ora shfaqet për rreth 8 sekonda.

Përdorimi i iPod/iPhone

Për të parandaluar rënien e iPod/iPhone, gjithmonë sigurojeni iPod/iPhone me krahun mbajtës kur përdorni iPod/iPhone me këtë sistem. Kur hiqni iPod/iPhone, ngrijeni krahun mbajtës derisa të dëgjohet një kërcitje dhe të futet në vend dhe më pas shkëputni iPod/iPhone nga konektori i iPod/iPhone.

1 Vendoseni iPod/iPhone në konektorin e iPod/iPhone.
2 Shtypni butonin PUSH derisa krahu mbajtës të lirohet me një kërcitje.
Krahu mbajtës kthehet jashtë për të siguruar iPod/iPhone.



Shënim për përdoruesit e modelit iPod nano
MOS e instaloni sistemin vertikalisht kur përdorni modelet iPod nano me këtë sistem. Modelet iPod nano nuk mund të sigurohen me krahun mbajtës për shkak të peshës. Instalimi i sistemit horizontalisht.

Shënim mbi transportimin e sistemit
MOS e transportoni sistemin me iPod/iPhone të lidhur. Nëse e bëni këtë, iPod/iPhone mund të bjerë dhe të dëmtohet. Sony nuk mund të pranojë përgjegjësinë për ndonjë dëmtim të shkaktuar nga përdorimi i papërshtatshëm.

Shënime
- Kur përdorni kasat për iPod/iPhone që blihen në treg, iPod/iPhone i lidhur mund të mos njihet nga sistemi. Nëse ndodh kjo, hiqeni kasën nga iPod/iPhone dhe rilidheni me konektorin e iPod/iPhone.
- Kur përdorni një sistemi të instaluar vertikalisht, sigurohuni që iPod/iPhone i lidhur të qëndrojë drejt, jo i anuar.

Përdorimet

Luajtja e iPod/iPhone

1 Zgjidhni funksionin e iPod.
Shtypni FUNCTION +/– 7 në mënyrë të përsëritur.
2 Vendoseni iPod/iPhone në konektorin e iPod/iPhone 12.
3 Shtypni butonin PUSH sërish dhe sigurojeni iPod/iPhone.
4 Filloni riprodhimin.
Shtypni ► 14.

Për të kontrolluar iPod/iPhone

Për	Shtypni
Vendos në pauzë riprodhimin	❚❚ (pauzë) 14/■ (ndalon) 14.
Zgjidhni një pjesë ose kapitull të audiolibrit/podkastit	⏮ (shko prapa)/⏭ (shko përpara) 11. Për të shpejtuar përpara ose prapa, mbani shtypur butonin.
Gjeni një pikë në një pjesë ose kapitull të audiolibrit/podkastit	Mbani shtypur ◄◄ (përshpejtim prapa)/►► (përshpejtim përpara) 11 gjatë riprodhimit, dhe lëshojeni butonin në pikën e dëshiruar.
Zgjidhni artikullin e zgjedhur	⊕ (hyrje) 17.
Rrotullo lart/poshtë menyve të iPod	↑/↓ 20.
Kthehuni në menynë e mëparshme ose zgjidhni një meny	TOOL MENU 18/RETURN ↶ (kthimi) 19.

Për të përdorur sistemin si karikues baterie

Sistemin mund ta përdorni si karikues baterie për një iPod/iPhone qoftë kur sistemi është i ndezur apo i fikur. Kur karikoni iPod/iPhone ndërkohë që sistemi është i ndezur, sigurohuni që të zgjidhni një funksion tjetër nga funksioni USB.
Karikimi fillon kur iPod/iPhone vendoset në konektorin e iPod/iPhone 12. Statusi i karikimit shfaqet në ekranin e iPod/iPhone. Kur karikoni iPod/iPhone, vendoseni iPod/iPhone në konektor me luajtësin e iPod/iPhone të ndalur.
Për detaje, shihni udhëzuesin e përdorimit të iPod/iPhone tuaj.

Për të ndaluar karikimin e një iPod/iPhone

Hiqni iPod/iPhone.

Shënime mbi karikimin e një iPod/iPhone
- Kur zgjidhet funksioni USB gjatë kohës që sistemi është i ndezur, nuk mund të karikoni iPod/iPhone.
- Nëse modaliteti është ai i demonstrimit ose orës, nuk mund të karikoni iPod/iPhone edhe nëse sistemi është i fikur.
- Nëse shtypni DISPLAY 25 gjatë kohës kur sistemi është i fikur, sistemi ndalon së karikuari iPod/iPhone. Për të rinisur karikimin e një iPod/iPhone, rilidheni iPod/iPhone kur modaliteti i ekranit është modaliteti i kursimit të energjisë.

Shënime
- Çaktivizoni funksionin "Shake to Shuffle" në iPod/iPhone për të shmangur ndryshimet e papritura të pjesëve muzikore kur dëgjoni muzikë me volum të lartë.
- Nëse bateria e iPod/iPhone është bosh, sistemi mund të mos e njohë. Nëse këtë rast, rikarikojeni me një kompjuter, etj. më pas lidheni me sistemin.
- Performanca e sistemit mund të variojë, në varësi të specifikimeve të iPod/iPhone tuaj.
- Kur vendosni ose hiqni iPod/iPhone, trajtojeni iPod/iPhone në të njëjtin kënd si ai i konektorit të iPod/iPhone në njësi dhe mos e rrotulloni apo tundni iPod/iPhone për të parandaluar dëmtimin e konektorit.
- Mos e transportoni njësinë me një iPod/iPhone të vendosur në konektor. Duke vepruar kështu mund të shkaktoni keqfunksionim.
- Kur vendosni ose hiqni iPod/iPhone, shtrëngojeni njësinë me njërën dorë dhe kujdesuni të mos shtypni kontrollet e iPod/iPhone gabimisht.
- Përpara se të shkëputni iPod/iPhone, vendosni riprodhimin në pauzë.
- Mbani shtypur ⏮/⏭ 11 për të përshpejtuar prapa (ose përshpejtuar përpara) ndërkohë që luani videon nëse ◄◄/►► 11 nuk funksionon.
- Për të ndryshuar nivelin e volumit, përdorni VOLUME +/– 1. Niveli i volumit nuk ndryshon nëse e rregulloni në iPod/iPhone.
- Ky sistem është projektuar vetëm për iPod/iPhone. Me konektorin e iPod/iPhone nuk mund të lidhni asnjë lloj pajisjeje tjetër luajtëse portative audio.
- Për të përdorur një iPod/iPhone, referojuni udhëzuesit të përdorimit të iPod/iPhone tuaj.
- Sony nuk mund të pranojë përgjegjësinë në rast e të dhënat e regjistruara në iPod/iPhone humbasin ose dëmtohen kur përdorni një iPod/iPhone të lidhur me këtë sistem.

Luajtja e një skedari të pajisjes USB

Formati audio që mund të luhet në këtë sistem është MP3/WMA*/AAC*.
* Skedarët me mbrojtje të të drejtave të autorit DRM (Digital Rights Management) ose skedarët e shkarkuar nga një dyqan muzikor në internet nuk mund të luhen në këtë sistem. Nëse provoni të luani një nga këta skedarë, sistemi luan skedarin audio të radhës që është i pambrojtur.

Kontrolloni uebsajtet e mëposhtme për informacion mbi pajisjet e pajtueshme USB.
Për klientët në Amerikën Latine:
<http://esupport.sony.com/LA>
Për klientët në Evropë dhe Rusi:
<http://support.sony-europe.com/>
Për klientët në vende/rajone të tjera:
<http://www.sony-asia.com/support>

1 Zgjidhni funksionin USB.
Shtypni FUNCTION +/– 7 në mënyrë të përsëritur.
2 Lidhni pajisjen USB me portën ⭠ (USB) 13.
3 Filloni riprodhimin.
Shtypni ► 14.

Përdorimet e tjera

Për	Shtypni
Vendos në pauzë riprodhimin	❚❚ (pauzë) 14. Për të rifilluar luajtjen, shtypni butonin sërish.
Ndaloni luajtjen	■ (ndalo) 14. Për të rifilluar luajtjen, shtypni ► (luaj) 14*1. Për të anuluar luajtjen, shtypni ■ 14 sërish*2.
Zgjidhni një dosje	⊟ +/– 10 në mënyrë të përsëritur.
Zgjidhni një skedar	⏮ (shko prapa)/⏭ (shko përpara) 11.
Gjeni një pikë në një skedar	Mbani shtypur ◄◄ (përshpejtim prapa)/►► (përshpejtim përpara) 11 gjatë riprodhimit, dhe lëshojeni butonin në pikën e dëshiruar.
Zgjidhni luajtjen e përsëritur	REPEAT 23 në mënyrë të përsëritur derisa të shfaqet "⟲" (përsërit të gjitha pjesët) ose "⟲1" (përsërit një pjesë).

*1 Kur luani një skedar VBR MP3/WMA, sistemi mund ta rifillojë riprodhimin nga një pikë tjetër.
*2 Rifillimi i luajtjes kthehet në dosjen kryesore.

Për të ndryshuar modalitetin e luajtjes

Shtypni PLAY MODE 22 në mënyrë të përsëritur. Mund të zgjidhni modalitetin e luajtjes normale (riprodhimi në sekuencë i të gjithë skedarëve në pajisjen USB), modaliteti i luajtjes së dosjes ("FLDR" për të gjithë skedarët në dosjen e specifikuar në pajisjen USB), ose modaliteti e luajtjes me përzierje ("SHUF").

Shënime mbi modalitetin e luajtjes
- Kur zgjidhni modalitetin e luajtjes me përzierje "SHUF", sistemi luan me përzierje të gjithë skedarët audio në pajisjen e lidhur USB sipas një rendi të rastësishëm. Modaliteti i luajtjes së përzier mund të luajë të njëjtin skedar në mënyrë të përsëritur.
- Kur modaliteti i luajtjes vendoset në modalitetin e luajtjes së dosjes, "⟲1" nuk është i disponueshëm.
- Kur modaliteti i luajtjes vendoset në modalitetin e luajtjes me përzierje, funksioni i përsëritjes nuk është i disponueshëm.
- Kur vendoset luajtja e përsëritur, modaliteti i luajtjes me përzierje nuk është i disponueshëm. Kur luajtja me përsëritje vendoset në "⟲1", modaliteti i luajtjes së dosjes nuk është i disponueshëm.
- Kur fikni sistemin, modaliteti i zgjedhur i luajtjes me përzierje ("SHUF") pastrohet dhe modaliteti i luajtjes kthehet në modalitetin e luajtjes normale.

Shënim mbi përsëritjen e riprodhimit
Nëse zgjidhni "⟲" kur sistemi është në modalitetin e luajtjes normale, sistemi ekzekuton luajtjen e përsëritur të të gjithë skedarëve audio në pajisjen USB derisa të ndaloni riprodhimin. Nëse zgjidhni "⟲" kur sistemi është në modalitetin e luajtjes së dosjes, sistemi ekzekuton luajtjen e përsëritur të gjithë skedarëve audio në dosjen e zgjedhur derisa të ndaloni riprodhimin.

Shënime
- Kur nevojitet lidhja me kabllo USB, lidhni kabllon USB që keni marrë me pajisjen USB. Shihni manualin e përdorimit të dhënë me pajisjen USB për detaje mbi mënyrën e përdorimit.
- Mund të duhen rreth 10 sekonda përpara se të shfaqet "READING" në varësi të llojit të pajisjes USB të lidhur.
- Mos e lidhni sistemin dhe pajisjen USB përmes një qendre USB.
- Kur lidhet pajisja USB, sistemi lexon të gjithë skedarët në pajisjen USB. Nëse në pajisjen USB ka shumë dosje ose skedarë, mund të duhet një kohë e gjatë për të përfunduar leximin e pajisjes USB.
- Me disa pajisje të lidhura USB, pasi kryhet një veprim, mund të ketë një vonesë përpara se të kryhet nga sistemi.
- Nuk mund të garantohet përputhshmëria me të gjithë softuerët kodues/shkrues. Nëse skedarët audio në pajisjen USB janë koduar fillimisht me një softuer jo të përputhshëm, këto skedarë mund të prodhojnë zhurmë ose zë të ndërpreë, ose mund të mos luhen fare.
- Ky sistem nuk mund të luajë skedarët audio në pajisjen USB në rastet e mëposhtme;
  – kur numri total i skedarëve audio në një dosje i tejkalon 100.
  – kur numri total i skedarëve audio në një pajisje USB i tejkalon 10 000.
  – kur numri total i dosjeve në një pajisje USB i tejkalon 100 (duke përfshirë dosjen "ROOT" dhe dosjet bosh).
  Këto shifra mund të variojnë në varësi të skedarit dhe strukturës së dosjes. Mos ruani lloje të tjera skedarësh ose dosjesh të panevojshme në një pajisje USB që ka skedarë audio.
- Sistemi mund të riprodhojë vetëm deri në 8 dosje.
- Sistemi nuk mbështet domosdoshmërisht të gjitha funksionet e dhëna me një pajisje të lidhur USB.
- Rifillimi i luajtjes mund të anulohet kur shkëputni kordonin e energjisë.
- Dosjet që nuk kanë skedarë audio kapërcehen.
- Formatet audio të mbështetura që mund të dëgjoni me këtë sistem janë si më poshtë:
  – MP3: prapashtesa e skedarit ".mp3"
  – WMA: prapashtesa e skedarit ".wma"
  – AAC: prapashtesa e skedarit ".m4a"
  Vini re se edhe kur emri i skedarit ka prapashtesën e duhur të dosjes, nëse skedari aktual ndryshon, sistemi mund të prodhojë zhurmë ose mund të keqfunksionojë.

Për të përdorur sistemin si karikues baterie

Sistemin mund ta përdorni si karikues baterie për pajisjet USB që kanë funksion karikimi kur sistemi është i ndezur.
Shtypni FUNCTION +/– 7 në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur funksionin USB.
Karikimi fillon kur pajisja USB është e lidhur me portën ⭠ (USB) 13. Statusi i karikimit shfaqet në ekranin e pajisjes USB. Për detaje, shihni udhëzuesin e përdorimit të pajisjes suaj USB.

Dëgjimi i radios

1 Zgjidhni funksionin e sintonizuesit (TUNER FM/TUNER AM).
Shtypni FUNCTION +/– 7 në mënyrë të përsëritur.
2 Kryeni sintonizimin.

Për skanim automatik

Shtypni TUNING MODE 22 në mënyrë të përsëritur derisa të shfaqet "AUTO", dhe më pas shtypni +/– 11. Skanimi ndalon automatikisht dhe "TUNED" dhe "ST" (vetëm për programet stereo) ndizet në ekran 8 kur gjendet një stacion.

Nëse "TUNED" nuk ndizet dhe skanimi nuk ndalon, shtypni ■ 14 për të ndaluar skanimin, më pas kryeni sintonizimin manual (më poshtë).
Kur sintonizoheni në një stacion FM që ofron shërbime RDS, nga transmetuesi ofrohet informacion i tillë si emri i shërbimit ose emri i stacionit.

Për sintonizimin manual

Shtypni TUNING MODE 22 në mënyrë të përsëritur derisa të zhduket "AUTO" dhe "PRESET", dhe më pas shtypni +/– 11 në mënyrë të përsëritur për t'u sintonizuar në stacionin e dëshiruar.

Këshillë
Për të reduktuar zhurmën statike në një stacion të dobët stereo FM, shtypni FM MODE 23 në mënyrë të përsëritur derisa të shfaqet "MONO" për të çaktivizuar marrjen stereo. Do të humbini efektin stereo, por do të përmirësohet marrja.

Paravendosja e stacioneve të radios

1 Sintonizohuni në stacionin e dëshiruar.

2 Shtypni TUNER MEMORY 21 për të zgjedhur modalitetin e memories së sintonizuesit.

3 Shtypni +/– 11 në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur numrin e dëshiruar të paravendosur.

Nëse numrit të zgjedhur i është caktuar tashmë një stacion tjetër radioje, stacioni zëvendësohet nga stacioni i ri.

4 Shtypni ⊕ 17 për të ruajtur stacionin.

5 Përsëritni hapat 1 deri 4 për të ruajtur stacionet e tjera.

Ju mund të paravendosni deri në 20 stacione FM dhe 10 stacione AM.

6 Për të thirrur një stacion të paravendosur radio, shtypni TUNING MODE 22 në mënyrë të përsëritur derisa të shfaqet "PRESET", dhe më pas shtypni +/– 11 në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur numrin e paravendosur të dëshiruar.

Përdorimi i komponentëve opsionalë audio

1 Përgatitni burimin e zërit.

Lidhni komponentin shtesë audio me foletë DVD/PC IN L/R 15 në njësi duke përdorur një kordon analog audio (nuk jepet).

2 Vendoseni nivelin e volumit në minimum.

Shtypni VOLUME – 1 në mënyrë të përsëritur derisa "VOL MIN" të shfaqet në ekran 8.

3 Zgjidhni funksionin DVD/PC.

Shtypni FUNCTION +/– 7 në mënyrë të përsëritur.

4 Filloni riprodhimin.

Filloni riprodhimin e komponentit të lidhur dhe rregulloni volumin.

Shënim

Sistemi mund të kalojë automatikisht në modalitetin e gatishmërisë nëse niveli i volumit të komponentit të lidhur është tepër i ulët. Rregulloni volumin e komponentit përkatësisht. Shihni "Për të fikur funksionin e gatishmërisë automatike".

Rregullimi i zërit

Për	Shtypni
Rregulloni volumin	VOLUME +/– 1.
Prodhoni një tingull më dinamik	BASS BOOST 2 në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur "BASS ON".
Vendosja e efektit zanor	EQ 3 në mënyrë të përsëritur.

Vendosja e ndriçimit të dritës së altoparlantit

Ju mund të vendosni ndriçimin e dritës së altoparlantit duke zgjedhur nga një shumëllojshmëri modelesh ndriçimi. Ndriçimi i dritës së altoparlantit do të krijojë efekte ndriçimi në bazë të burimit të muzikës.

Shtypni LED SPEAKER 4 në mënyrë të përsëritur.

Sa herë që shtypni këtë buton, modeli ndryshon.

Për të fikur funksionin e dritës së altoparlantit

Shtypni LED SPEAKER 4 në mënyrë të përsëritur derisa të shfaqet "LED OFF".

Ndryshimi i ekranit

Për	Shtypni
Ndryshoni informacionin në ekran 8[1]	DISPLAY 25 në mënyrë të përsëritur kur sistemi është i ndezur.
Ndryshoni modalitetin e shfaqjes (shihni më poshtë).	DISPLAY 25 në mënyrë të përsëritur kur sistemi është i fikur.[2]

[1] Për shembull, mund të shihni informacionin e pajisjes USB, si p.sh.:
– numrin e pjesës ose skedarit
– emrin e pjesës ose skedarit ("♫")
– emrin e artistit ("👤")
– emrin e albumit ("💿")
– emrin e dosjes ("🗀")

[2] Treguesi i gatishmërisë 6 në njësi ndizet kur sistemi është i fikur.

Sistemi ofron modalitetet e mëposhtme të ekranit.

Modaliteti i ekranit	Kur sistemi është i fikur[1]
Demonstrimi	Demonstrimi është i ndezur.
Modaliteti i kursimit të energjisë[2]	Ekrani është fikur për të kursyer energji. Kohëmatësi dhe ora vazhdojnë të punojnë.
Ora[3]	Ora shfaqet.

[1] Treguesi i gatishmërisë 6 në njësi ndizet kur sistemi është i fikur.
[2] Ju nuk mund të vendosni orën në modalitetin e kursimit të energjisë.
[3] Shfaqja e orës kalon automatikisht në modalitetin e kursimit të energjisë pas 8 sekondash.

Shënime mbi informacionin e ekranit

- Karakteret që nuk mund të paraqiten, shfaqen si "_".
- Koha totale e luajtjes për një pajisje USB nuk shfaqet.
- Të mëposhtmet nuk shfaqen saktë:
  – koha e kaluar e luajtjes së një skedari MP3 të koduar duke përdorur VBR (shpejtësi bit të ndryshueshme).
  – emrat e dosjeve dhe skedarëve që nuk ndjekin ISO9660 Niveli 1, Niveli 2 ose Joliet në formatin e zgjerimit.
- Informacioni i etiketës ID3 për skedarët MP3 shfaqet kur përdoren etiketat e versionit 1 dhe versionit 2 të ID3 (shfaqja e informacionit të etiketës së versionit 2 të ID3 ka prioritet kur përdoren etiketat e versioneve 1 dhe 2 të ID3 për një skedar të vetëm MP3).

Përdorimi i kohëmatësve

Sistemi ofron 2 funksione kohëmatësi. Nëse përdorni të dy kohëmatësit, ka prioritet kohëmatësi i fjetjes.

Kohëmatësi i fjetjes:

Mund të ndodhë që t'ju zërë gjumi duke dëgjuar muzikë. Ku funksion funksionon edhe nëse nuk është vendosur ora.

Shtypni SLEEP 24 në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur kohën e dëshiruar.
Për të anuluar kohëmatësin e fjetjes, shtypni SLEEP 24 në mënyrë të përsëritur derisa të shfaqet "OFF".

Kohëmatësi i luajtjes:

Ju mund të zgjoheni nga radioja FM/AM, pajisja iPod/iPhone ose USB në kohën e paravendosur. Sigurohuni që të keni vendosur orën.

1 Përgatitni burimin e zërit.

Përgatitni burimin e zërit, më pas shtypni VOLUME +/– 1 për të rregulluar volumin.

2 Zgjidhni modalitetin e vendosur të kohëmatësit.

Shtypni TIMER MENU 16.

3 Vendosni kohëmatësin e luajtjes.

Shtypni ↑/↓ 20 në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur "PLAY SET", më pas shtypni ⊕ 17.

4 Vendosni kohën për të nisur riprodhimin.

Shtypni ↑/↓ 20 në mënyrë të përsëritur për të vendosur orën, më pas shtypni ⊕ 17. Përdorni të njëjtën procedurë për të vendosur minutat.

5 Përdorni të njëjtën procedurë si në hapin 4 për të vendosur kohën për të ndaluar riprodhimin.

6 Zgjidhni burimin e zërit.

Shtypni ↑/↓ 20 në mënyrë të përsëritur derisa të shfaqet burimi i dëshiruar i zërit, më pas shtypni ⊕ 17.

7 Fikni sistemin.

Shtypni I/⏻ 5. Sistemi ndizet automatikisht përpara kohës së paravendosur.

Nëse sistemi është i ndezur në kohën e paravendosur, kohëmatësi i luajtjes nuk do të aktivizohet. Mos e përdorni sistemin nga koha kur sistemi ndizet deri kur fillon riprodhimi.

Për të kontrolluar cilësimin

1 Shtypni TIMER MENU 16.

2 Shtypni ↑/↓ 20 në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur "SELECT", dhe më pas shtypni ⊕ 17.

3 Shtypni ↑/↓ 20 në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur "PLAY SEL", dhe më pas shtypni ⊕ 17.

Për të anuluar kohëmatësin

Përsëritni të njëjtën procedurë si më lart derisa të shfaqet "OFF" në hapin 3, dhe më pas shtypni ⊕ 17.

Për të ndryshuar cilësimin

Filloni sërish nga hapi 1 "Përdorimi i kohëmatësve".

Shënim

Nëse zgjidhni një pajisje USB si burim riprodhimi dhe mund të keni skedarë ose dosje në atë pajisje, duhet kohë për procesin e leximit, gjë që shkakton një vonesë të vogël përpara nisjes së luajtjes në përgjigje të kohëmatësit.

Shënime mbi përdoruesin e iPod/iPhone

- Sigurohuni që iPod/iPhone të mos jetë duke luajtur kur përdorni kohëmatësin e luajtjes.
- Kohëmatësi i luajtjes mund të mos aktivizohet, në varësi të statusit të iPod/iPhone të lidhur.

Këshillë

Cilësimi i kohëmatësit të luajtjes mbetet për sa kohë që cilësimi nuk anulohet automatikisht.

Zgjidhja e problemeve

1 Sigurohuni që kordoni i rrymës të jetë lidhur saktë dhe mirë.

2 Gjeni problemin që keni në listën e mëposhtme dhe merrni masën e treguar korrigjuese.

Nëse problemi vazhdon, kontaktoni shitësin më të afërt të Sony.

Nëse treguesi i gatishmërisë 6 pulson

Menjëherë shkëputni kordonin e rrymës dhe kontrolloni si më poshtë.

- A po bllokon ndonjë gjë vrimat e ajrimit të sistemit?
- A krijon qark të shkurtër konektori i iPod/iPhone 12?

Pasi treguesi i gatishmërisë 6 ndalon së pulsuari, rilidheni kordonin e rrymës dhe ndizni sistemin. Nëse problemi vazhdon, kontaktoni shitësin më të afërt të Sony.

Të përgjithshme

Në ekran shfaqet demonstrimi 8 pas futjes së kordonit të rrymës edhe pse sistemi nuk është i ndezur.

- Shtypni DISPLAY 25 një herë ndërkohë që sistemi është i fikur. Demonstrimi zhduket.
- Vendosni orën. Shihni "Vendosja e orës".

Sistemi nuk ndizet.

- A është futur në prizë kordoni i rrymës?

Sistemi ka kaluar papritur në modalitet gatishmërie.

- Ky nuk është keqfunksionim. Sistemi hyn automatikisht në modalitetin e gatishmërisë, pas rreth 30 minutash kur nuk e përdorni sistemin ose kur nuk ka dalje sinjali audio. Shihni "Për të fikur funksionin e gatishmërisë automatike".

Cilësimi i orës ose përdorimi i kohëmatësit të luajtjes është anuluar papritur.

- Nëse ka kaluar rreth një minutë pa përdorim, cilësimi i orës ose cilësimi i kohëmatësit të luajtjes anulohet automatikisht. Kryeni operacionin nga fillimi.

Nuk ka zë.

- A po bllokon ndonjë gjë vrimat e ajrimit të sistemit?
- Stacioni i specifikuar mund të ketë ndaluar përkohësisht transmetimet.

Gumëzhitje ose zhurmë e madhe.

- Lëvizeni sistemin larg burimeve të tjera të zhurmës.
- Lidheni sistemin me një prizë tjetër muri.
- Instaloni një filtër zhurme (nuk jepet) te kordoni i rrymës.

Telekomanda nuk funksionon.

- Hiqni çdo pengesë që ndodhet mes telekomandës dhe sensorit të telekomandës 9 në njësi, dhe pozicionojeni njësinë larg nga dritat fluoreshente.
- Drejtojani telekomandën sensorit të sistemit 9.
- Lëvizeni telekomandën më pranë sistemit.
- Bateritë e telekomandës mund të kenë rënë. Zëvendësoni bateritë (R6/përmasa AA) me të reja.

Treguesi i gatishmërisë 6 mbetet i ndezur pasi shkëputni kordonin e rrymës.

- Treguesi i gatishmërisë 6 mund të mos fiket menjëherë pasi shkëputni kordonin e rrymës. Treguesi do të fiket automatikisht pas rreth 40 sekondash. Ky nuk është keqfunksionim.

Përveç I/⏻ 5, asnjë buton në njësi nuk punon dhe në ekran shfaqet "CHILD LOCK" 8.

- Është aktivizuar funksioni i bllokimit për fëmijët. Për të çaktivizuar bllokimin për fëmijët, mbani shtypur ■ 14 në njësi derisa "CHILD LOCK OFF" të shfaqet në ekran 8.

iPod/iPhone

Nuk ka zë.

- Sigurohuni që iPod/iPhone të jetë lidhur mirë.
- Sigurohuni që iPod/iPhone të jetë duke luajtur muzikë.
- Sigurohuni që iPod/iPhone të jetë përditësuar me softuerin më të fundit. Nëse jo, përditësoni iPod/iPhone përpara se të përdorni sistemin.
- Rregulloni volumin.

Zëri është i distortuar.

- Sigurohuni që iPod/iPhone të jetë lidhur mirë.
- Ulni volumin.
- Vendosni cilësimin "EQ" të iPod/iPhone në "Off" ose "Flat".

Gjatë riprodhimit ndodhin ndryshime të papritura të pjesës.

- Çaktivizoni funksionin "Shake to Shuffle" (ndryshimin e pjesëve duke tundur iPod/iPhone) në iPod/iPhone kur dëgjoni muzikë në iPod/iPhone me volum të lartë. Nëse ky funksion është i aktivizuar, mund të ndodhin ndryshime të pjesëve për shkak të dridhjeve të shkaktuara nga presioni i zërit nga sistemi.

iPod/iPhone nuk funksionon.

- Nëse bateria e iPod/iPhone është bosh, ai mund të mos funksionojë me sistemin. Nëse këtë rast, rikarikojeni me një kompjuter, etj. më pas lidheni me sistemin.
- Mbyllni të gjitha aplikacionet që po ekzekutohen në iPod ose iPhone përpara se ta përdorni atë me sistemin. Për detaje, referojuni manualit të përdorimit të dhënë me iPod/iPhone.
- Sigurohuni që iPod/iPhone të jetë lidhur mirë.
- Sigurohuni që iPod/iPhone të jetë përditësuar me softuerin më të fundit. Nëse jo, përditësoni iPod/iPhone përpara se të përdorni sistemin.
- Duke qenë se përdorimi i sistemit dhe i iPod/iPhone janë të ndryshëm, ju nuk mund të përdorni iPod/iPhone duke përdorur butonat në telekomandë ose njësi. Në këtë rast, përdorni butonat e kontrollit në iPod/iPhone.

iPod/iPhone nuk karikohet.

- Nëse bateria e iPod/iPhone është bosh, sistemi mund të mos jetë në gjendje të karikojë edhe nëse e lidhni me sistemin. Nëse këtë rast, rikarikojeni me një kompjuter, etj. më pas lidheni me sistemin.
- Sigurohuni që iPod/iPhone të jetë lidhur mirë.
- Kur karikoni një iPod/iPhone gjatë kohës që sistemi është i fikur (modaliteti i gatishmërisë), sistemi nuk kryen karikimin nëse iPod/iPhone është plotësisht i karikuar.
- Sigurohuni që sistemi të mos jetë në modalitetin e funksionit USB. Një iPod/iPhone nuk mund të karikohet në modalitetin e funksionit USB.
- Ju nuk mund ta karikoni iPod/iPhone përmes portës ⭠ (USB) 13 në njësi, edhe nëse përdoreni kabllon USB që keni marrë me iPod/iPhone tuaj. Për ta karikuar, gjithmonë lidheni iPod/iPhone me konektorin iPod/iPhone 12 në njësi.

Niveli i ziles së iPhone nuk ndryshon.

- Rregulloni volumin e ziles në iPhone.

Pajisje USB

Pajisja e lidhur iPod/iPhone ose USB nuk karikohet, kur të dyja janë të lidhura njëkohësisht.

- Ju nuk mund të karikoni një iPod/iPhone dhe pajisjen USB njëkohësisht. Zgjidhni funksionin USB për të karikuar pajisjen USB.

A përdorni pajisje të mbështetur USB?

- Nëse lidhni një pajisje të pambështetur USB, mund të ndodhin problemet e mëposhtme. Kontrolloni informacionin në uebsajte mbi pajisjet e përputhshme USB me URL-të e listuara në "Luajtja e një skedari të pajisjes USB".
  – Pajisja USB nuk njihet.
  – Emrat e skedarëve ose dosjeve nuk shfaqen.
  – Riprodhimi nuk është i mundur.
  – Zëri kapërcehet.
  – Ka zhurmë.
  – Zëri del i distortuar.

Shfaqet "OVER CURRENT".

- Është diktuar një problem me nivelin e rrymës elektrike nga porta ⭠ (USB) 13. Fikni sistemin dhe hiqni pajisjen USB nga porta ⭠ (USB) 13. Sigurohuni që të mos ketë probleme me pajisjen USB. Nëse modeli i ekranit vazhdon, kontaktoni shitësin më të afërt të Sony.

Nuk ka zë.

- Pajisja USB nuk është lidhur saktë. Fikni sistemin dhe më pas rilidhni pajisjen USB.

Ka zhurmë, kapërcim të zërit ose zë të distortuar.

- Fikni sistemin dhe më pas rilidhni pajisjen USB.
- Vetë të dhënat muzikore përmbajnë zhurmë ose zëri është i distortuar. Mund të ketë hyrë zhurmë gjatë krijimit të të dhënave muzikore për shkak të kushteve të kompjuterit. Krijoni sërish të dhënat muzikore.
- Shpejtësia bit e përdorur gjatë enkodimit të skedarëve ka qenë e ulët. Dërgoni në pajisjen USB skedarë të enkoduar me shpejtësi të lartë bit.

Shfaqet "READING" për një kohë të gjatë, ose duhet shumë kohë përpara se të fillojë riprodhimi.

- Procesi i leximit mund të kërkojë një kohë të gjatë në rastet e mëposhtme.
  – Ka shumë skedarë ose dosje në pajisjen USB.
  – Struktura e skedarit është jashtëzakonisht komplekse.
  – Është tejkaluar kapaciteti i memories.
  – Memoria e brendshme është fragmentuar.

Ekran gabimi.

- Dërgoni sërish të dhënat muzikore drejt pajisjes USB, duke qenë se të dhënat e ruajtura në pajisjen USB mund të jenë prishur.
- Kodet e karaktereve që mund të shfaqen nga ky sistem janë vetëm numrat dhe alfabetet. Karakteret e tjera nuk shfaqen saktë.

Pajisja USB nuk njihet.

- Fikni sistemin dhe rilidhni pajisjen USB, më pas ndizeni sistemin.
- Kontrolloni informacionin në uebsajte mbi pajisjet e përputhshme USB me URL-të e listuara në "Luajtja e një skedari të pajisjes USB".

Pajisja USB nuk punon mirë.

- Referojuni manualit të përdorimit të pajisjes USB për mënyrën e zgjidhjes së këtij problemi.

Luajtja nuk fillon.

- Fikni sistemin dhe rilidhni pajisjen USB, më pas ndizeni sistemin.
- Kontrolloni informacionin në uebsajte mbi pajisjet e përputhshme USB me URL-të e listuara në "Luajtja e një skedari të pajisjes USB".
- Shtypni ► 14 për të filluar riprodhimin.

Luajtja nuk fillon të luhet nga pjesa e parë.

- Vendoseni modalitetin e luajtjes në modalitetin e luajtjes normale.

Skedarët nuk mund të luhen.

- Skedari audio nuk ka prapashtesën ".mp3", ".wma" ose ".m4a".
- Të dhënat nuk janë krijuar në formatin MP3/WMA/AAC.
- Pajisjet USB të formatuara me sisteme skedarësh ndryshe nga FAT16 ose FAT32 nuk mbështeten.*
- Nëse përdorni një pajisje USB me ndarje, mund të luhen vetëm skedarët e ndarjes së parë.
- Skedarët e shifruar ose të mbrojtur me fjalëkalime, etj. nuk mund të riprodhohen.

* Ky sistem mbështet FAT16 dhe FAT32, por disa pajisje USB mund të mos i mbështetin të gjitha këto lloje FAT. Për detaje, shihni manualin e përdorimit të secilës pajisje USB ose kontaktoni prodhuesin.

Sintonizuesi

Gumëzhitje ose zhurmë e fortë, ose nuk merren stacione. ("TUNED" ose "ST" pulson në ekran 8.)

- Lidheni antenën siç duhet.
- Provoni një vend dhe orientim tjetër për marrje më të mirë të antenës.
- Mbajini antenat larg nga kordoni i rrymës për të shmangur marrjen e zhurmës.
- Fikni çdo pajisje elektrike që ndodhet afër.

Për të ndryshuar intervalin e sintonizimit AM (përveç modeleve të Evropës, Rusisë dhe Arabisë Saudite)

Intervali i sintonizimit AM është i paravendosur në 9 kHz ose 10 kHz si parazgjedhje e fabrikës. Përdorni butonat në njësi për ët ndryshuar intervalin e sintonizimit AM.

1 Sintonizohuni në një stacion AM, më pas fikni sistemin.

2 Shtypni DISPLAY 25 për të shfaqur orën.

3 Duke mbajtur shtypur FUNCTION 7, shtypni I/⏻ 5.

Të gjitha stacionet e paravendosura AM fshihen. Për të rivendosur intervalin në parazgjedhjen e fabrikës, përsëritni procedurën.

Për të rivendosur sistemin në cilësimet e fabrikës

Nëse sistemi ende nuk funksionon mirë, rivendosni sistemin në cilësimet e fabrikës.
Përdorni butonat në njësi derisa të rivendosni njësinë në cilësimet e parazgjedhura.

1 Shkëputni dhe rilidhni kordonin e rrymës, dhe më pas ndizni sistemin.

2 Mbani shtypur ►II 14 dhe shtypni I/⏻ 5 derisa të shfaqet "RESET".

Fshihen të gjitha cilësimet e konfiguruara nga përdoruesi, siç janë stacionet e paravendosura të radios, kohëmatësi dhe ora.

Për të fikur funksionin e gatishmërisë automatike

Ky sistem është i pajisur me një funksion të gatishmërisë automatike. Me këtë funksion, sistemi hyn automatikisht në modalitetin e gatishmërisë, pas rreth 30 minutash kur nuk e përdorni sistemin ose kur nuk ka dalje sinjali audio.
Si parazgjedhje, funksioni i gatishmërisë automatike është i ndezur.
Përdorni butonat në njësi për të fikur funksionin e gatishmërisë automatike.

Mbani shtypur I/⏻ 5 ndërkohë që sistemi është i ndezur, derisa të shfaqet "AUTO.STBY OFF".

Për të ndezur funksionin, përsëritni procedurën derisa të shfaqet "AUTO.STBY ON".

Shënime

- Mesazhi "AUTO.STBY" fillon të pulsojë në ekran për rreth 2 minuta përpara se të hyjë në modalitetin e gatishmërisë.
- Funksioni i gatishmërisë automatike është i pavlefshëm për funksionin e kohëmatësit (FM/AM), edhe kur e keni aktivizuar.
- Sistemi mund të mos kalojë automatikisht në modalitetin e gatishmërisë në rastet e mëposhtme;
  – kur diktohet sinjal audio.
  – kur është lidhur një pajisje USB.
  – gjatë riprodhimit të skedarëve audio.
  – gjatë kohës që kohëmatësi i luajtjes ose kohëmatësi i fjetjes i parazgjedhur është në proces.

Mesazhet

CHARGING: iPod/iPhone karikohet kur sistemi është i fikur (modaliteti i gatishmërisë).

CHILD LOCK: Është aktivizuar funksioni i bllokimit për fëmijët. Për të çaktivizuar bllokimin për fëmijët, mbani shtypur ■ 14 në njësi derisa "CHILD LOCK OFF" të shfaqet në ekran 8.

ERROR: Pajisja USB nuk njihet ose është lidhur një pajisje e panjohur.

NoDEVICE: Nuk është lidhur pajisje USB ose pajisja e lidhur USB është hequr.

NoMEMORY: Mjeti i memories nuk është futur në pajisjen USB.

NO TRACK: Skedari i luajtshëm në pajisjen USB nuk është ngarkuar në sistem.

NOT USED: Jeni përpjekur të kryeni një përdorim specifik në kushtet ku ai përdorim është i ndaluar.

NO SUPPORT: Është lidhur një pajisje e pambështetur USB, model i pambështetur iPod/iPhone, ose një iPod/iPhone me bateri të shkarkuar.

TIME NG: Koha e fillimit dhe përfundimit të kohëmatësit të luajtjes janë vendosur në të njëjtën kohë.

Masat paraprake

Mbi sigurinë

- Shkëputni plotësisht kordonin e rrymës (rrjeti elektrik) nga priza e murit (rrjeti) nëse nuk do të përdoret për një periudhë të gjatë kohe. Kur shkëputni njësinë, gjithmonë kapeni spinën. Asnjëherë mos tërhiqni vetë kordonin.
- Nëse brenda në sistem bie diçka e fortë ose lëng, sistemi duhet të hiqet nga priza dhe duhet të kontrollohet nga një personel i kualifikuar përpara se të vihet sërish në punë.
- Kordoni i rrymës së drejtpërdrejtë mund të zëvendësohet vetëm nga një pikë servisi e kualifikuar.

Mbi vendosjen

- Mos e vendosni sistemin në pozicion të pjerrët ose në vende jashtëzakonisht të nxehta, të fshta, me pluhur, të ndotura ose të lagështa ose ku mungon ajrosja e duhur, ose ku mund të ketë dridhje, dritë dielli të drejtpërdrejtë ose dritë të fortë.
- Kini kujdes kur vendosni sistemin mbi sipërfaqe me trajtim të veçantë (p.sh. të trajtuara me dyllë, vaj, me lustër, etj.) duke qenë se mund të rezultojë në njolla ose çngjyrosje.
- Në pjesën e jashtme të sipërfaqeve ose brenda mund të formohet kondensim dhe të shkaktojë keqfunksionim nëse sistemi zhvendoset papritur nga një mjedis i ftohtë në një të ngrohtë. Nëse formohet kondensim, fikeni sistemin dhe lëreni sistemin të fikur derisa të avullojë lagështira. Mos e përdorni sistemin derisa të ketë avulluar krejtësisht kondensimi.

Mbi akumulimin e nxehtësisë

- Akumulimi i nxehtësisë në njësi gjatë përdorimit është normal dhe nuk është shkak për t'u alarmuar.
- Mos e prekni kasën e pajisjes nëse është përdorur vazhdimisht me volum të lartë sepse mund të jetë nxehur.
- Mos bllokoni vrimat e ajrimit.

Mbi sistemin e altoparlantëve

Sistemi i inkorporuar i altoparlantëve nuk ka mbrojtje magnetike, dhe figura në televizorët pranë mund të distortohet magnetikisht. Në këtë situatë, fikni televizorin, prisni 15 deri 30 minuta, dhe ndizeni sërish. Nëse nuk ka përmirësime, zhvendoseni sistemin larg nga televizori.

Pastrimi i kasës së pajisjes

Pastroni këtë sistem me një pëlhurë të butë të njomur paksa me një solucion larës të butë. Mos përdorni asnjë lloj pastruesi abraziv, tela fërkimi ose tretës si hollues, benzinë ose alkool.

Specifikimet

Seksioni i amplifikatorit

Të mëposhtmet janë matur në rrymë të alternuar 120 V – 240 V, 50/60 Hz (modelet e Amerikës Latine (përveç modeleve të Meksikës dhe Argjentinës))
Të mëposhtmet janë matur në rrymë të alternuar 127 V, 60 Hz (modeli i Meksikës)
Të mëposhtmet janë matur në rrymë të alternuar 220 V – 240 V, 50/60 Hz (modelet e Evropës, Rusisë, Australisë dhe Argjentinës)
Të mëposhtmet janë matur në rrymë të alternuar 120 V – 240 V, 50/60 Hz (modelet e tjera)

FST-GTK33iP/RDH-GTK33iP
Dalja e fuqisë (nominale):
100 W + 100 W (në 3,5 Ω, 1 kHz, 1% THD)
Dalja e fuqisë RMS (referenca):
210 W + 210 W (për kanal në 3,5 Ω, 1 kHz)
FST-GTK11iP/RDH-GTK11iP
Dalja e fuqisë (nominale):
55 W + 55 W (në 3 Ω, 1 kHz, 1% THD)
Dalja e fuqisë RMS (referenca):
115 W + 115 W (për kanal në 3 Ω, 1 kHz)

Seksioni i altoparlantëve

Sistemi i altoparlantëve: Sistem altoparlantësh me 2 drejtime, reflektim bas
Njësitë e altoparlantit:
FST-GTK33iP/RDH-GTK33iP:
Vuferi: 200 mm, i llojit konik
Tweeter: 66 mm, i llojit konik
FST-GTK11iP/RDH-GTK11iP:
Vuferi: 160 mm, i llojit konik
Tweeter: 40 mm, i llojit konik
Rezistenca nominale:
FST-GTK33iP/RDH-GTK33iP: 3,5 Ω
FST-GTK11iP/RDH-GTK11iP: 3,0 Ω

Hyrje

DVD/PC IN (audio në L/R):
FST-GTK33iP/RDH-GTK33iP: Ndjeshmëria 1,000 mV, rezistenca 47 kΩ
FST-GTK11iP/RDH-GTK11iP: Ndjeshmëria 1,500 mV, rezistenca 47 kΩ

Seksioni iPod/iPhone

Konektori i iPod/iPhone:
Tensioni i daljes: DC 5 V
Rryma maksimale dalëse: 1 A
Modelet e përputhshme iPod/iPhone:
– iPod touch 4th generation
– iPod touch 3rd generation
– iPod touch 2nd generation
– iPod nano 6th generation
– iPod nano 5th generation (video camera)
– iPod nano 4th generation (video)
– iPod nano 3rd generation (video)
– iPod classic
– iPhone 4S
– iPhone 4
– iPhone 3GS
– iPhone 3G

"Made for iPod", dhe "Made for iPhone" nënkuptojnë se një aksesor elektronik është projektuar për t'u lidhur në mënyrë specifike përkatësisht me një iPod ose iPhone, dhe është certifikuar nga zhvilluesi i tij se përputhet me standardet e performancës së Apple. Apple nuk është përgjegjëse për funksionimin e kësaj pajisjeje ose pajtueshmërinë e saj me standardet rregullatore dhe të sigurisë.
Ju lutemi vini re se përdorimi i këtij aksesori me iPod ose iPhone mund të ndikojë në performancën e lidhjes me valë.

Seksioni USB

Shpejtësitë bit të mbështetura:
MP3 (MPEG 1 Audio Layer-3): 32 kbps – 320 kbps, VBR
WMA: 48 kbps – 192 kbps, VBR
AAC: 48 kbps – 320 kbps
Frekuencat shembull:
MP3 (MPEG 1 Audio Layer-3): 32/44.1/48 kHz
WMA: 44.1 kHz
AAC: 44.1 kHz
⭠ Porta (USB): Lloji A, rryma maksimale 500 mA

Seksioni i sintonizuesit

Sintonizues stereo FM, superheterodin FM/AM
Antena:
Antenë përcjellëse FM
Antena AM në formë kornize
Seksioni i sintonizuesit FM
Diapazoni i sintonizimit: 87.5 MHz – 108.0 MHz (hapa me nga 50 kHz)
Seksioni i sintonizuesit AM:
Diapazoni i sintonizimit:
Modelet e Evropës, Rusisë dhe Arabisë Saudite:
531 kHz – 1,602 kHz (hapa me nga 9 kHz)
Modelet e Amerikës Latine:
530 kHz – 1,710 kHz (hapa me nga 10 kHz)
531 kHz – 1,710 kHz (hapa me nga 9 kHz)
Modeli i Australisë:
531 kHz – 1,710 kHz (hapa me nga 9 kHz)
530 kHz – 1,710 kHz (hapa me nga 10 kHz)
Modelet e tjera:
531 kHz – 1,602 kHz (hapa me nga 9 kHz)
530 kHz – 1,610 kHz (hapa me nga 10 kHz)

Të përgjithshme

Furnizimi me energji:
Modelet e Amerikës Latine (përveç modeleve të Meksikës dhe Argjentinës):
AC 120 V – 240 V, 50/60 Hz
Modeli i Meksikës:
AC 127 V, 60 Hz
Modelet e Evropës, Rusisë, Australisë dhe Argjentinës:
AC 220 V – 240 V, 50/60 Hz
Modelet e tjera:
AC 120 V – 240 V, 50/60 Hz
Konsumi i energjisë:
FST-GTK33iP/RDH-GTK33iP: 75 W (0.5 W në modalitetin e kursimit të energjisë)
FST-GTK11iP/RDH-GTK11iP: 45 W (0.5 W në modalitetin e kursimit të energjisë)
Përmasat (gj/l/th) (afërsisht):
FST-GTK33iP/RDH-GTK33iP: Afërsisht 768.5 mm × 323 mm × 385 mm
FST-GTK11iP/RDH-GTK11iP: Afërsisht 678.5 mm × 323 mm × 385 mm
Masa:
FST-GTK33iP/RDH-GTK33iP: Afërsisht 14.0 kg
FST-GTK11iP/RDH-GTK11iP: Afërsisht 12.5 kg
Sasia e njësisë: 1 copë

Aksesorët e dhënë: Telekomanda (1), bateri R6 (përmasa AA) (2), antenë përcjellëse FM/antenë në formë kornize AM (1)

Dizajni dhe specifikimet janë subjekt ndryshimi pa dhënë njoftim.